



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2018, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu dhe Ismet Beqiraj.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Evis Kushi, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani - Drejtoreshë e fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Sot në rendin e ditës së punës të këtij komisioni ka vetëm një çështje: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Relator i komisionit për këtë çështje është zoti Ervin Bushati.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë, Gazmend Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Zoti Barbullushi, do të fillojmë me ju. Do ta bëni ju prezantimin e projektligjit dhe më pas relatori i komisionit. Do t’ju lutesha të jeni i hapur në rast se do të ketë pyetje nga kolegët e komisionit. E keni ju fjalën.

Gazmend Barbullushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot kemi nderin, në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të paraqesim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare krijon kushtet për zbatimin e përbashkët të projekteve për të ardhmen, midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke mundësuar në këtë mënyrë që përfituesit nga të dyja vendet të shkëmbejnë njohuri dhe përvoja, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, punësimit e të tjerë.

Projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje është propozuar nga Këshilli i Ministrave, përmes vendimit nr. 536 të vitit 2018. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, përmes vendimit nr. 249/2017, është nënshkruar nga pala jonë në korrik të vitit 2017, ndërsa nga pala kosovare në nëntor të vitit 2017.

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë 2014-2020, u miratua nga Komisioni European me vendimin e tij zbatues të vitit 2014.

Alokimet për vitin 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA, me një buxhet total prej afro 1 milion e 400 mijë euro për të dyja vendet, ndër të cilat, bashkëfinancimi kombëtar i shteteve është 180 mijë euro, ndërsa kontributi i Bashkimit European është rreth 1 milion e 200 mijë euro.

Zona e programit ku do të zbatohen projektet mbulon një territor prej afro 8500 kilometra katrorë, me një popullsi që arrin rreth 930 mijë banorë, 76% nga të cilët jetojnë në territorin e Kosovës dhe 24% në anën shqiptare të zonës së programit.

Në Shqipëri, zonat përfituese përfshijnë qarkun e Kukësit dhe të Lezhës, ku përfshihen 8 bashki në total, me 362 vendbanime, ndërsa në Kosovë përfshin rajonin ekonomik perëndimor dhe rajonin ekonomik jugor me 12 bashki.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë mbështet shkëmbimin e eksperiencës, të njohurive dhe përmirësimit të politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale e lokale, si dhe të aktorëve të tjerë të rajoneve të lejueshme në zonën e programit.

Programi ka si qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si dhe të forcojë më tej bashkëpunimin e natyrshëm mes dy shteteve.

Duke marrë parasysh problematikën në terren, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike:

së pari, në mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimaterike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut;

së dyti, në turizëm dhe në trashëgiminë kulturore e natyrore dhe, së fundi, në rini dhe arsim, me fokus nxitjen e punësimit.

Nuk po zgjatem më tej, zoti kryetar.

Jemi plotësisht në dispozicionin tuaj për pyetje apo sugjerime.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zot Barbullushi!

Zoti Bushati, urdhëroni!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë ka si qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si dhe të forcojë më tej bashkëpunimin natyral ndërmjet dy shteteve.

Programi ka reflektuar rëndësinë që Bashkimi European u kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale, çështje të reflektuara përmes përzgjedhjes së prioriteteve të tilla, si: krijimi i partneriteteve ndërkufitare; autorësia vendore dhe mundësitë e barabarta; garantimi i mosdiskreditimit të minoriteteve; mbrojtja e mjedisit; të drejtat gjinore e të tjerë.

Përmes këtij ratifikimi do të mundësohet zbatimi i projekteve specifike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat, përveç shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave, do të sjellin rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, punësimit e të tjera.

Marrëveshja financiare u nënshkrua për palën shqiptare në korrik të vitit 2017. Programi i veprimit dhe bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Shqipëri-Kosovë 2014-2020 u miratua nga Komisioni European me vendimin zbatues në dhjetor të vitit 2014. Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit European nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit me një buxhet total, për të dyja vendet, prej 1 411 765 euro dhe kontributi i unionit në vlerën 1 200 000 euro. Periudha e ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje financiare është 12 vjet nga hyrja në fuqi e saj.

Në total, kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Kosovë për periudhën 2014-2020 arrin vlerën 8 400 000 euro. Alokimet e mëtejshme do të jenë objekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European.

Në mënyrë më të detajuar programi do të fokusohet në këto prioritete:

1. Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut;
2. Turizmi dhe trashëgimia natyrore e kulturore;
3. Rinia dhe arsimi, me fokus nxitjen e punësimit.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga 5 pjesë:

1. Shtojca I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2015-2017 përmes të cilës bëhet përshkrimi i modaliteteve të zbatimit, përfshirë alokimet për çdo vit financiar.
2. Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, e cila trajton karakteristikat e territorit, prioritet dhe një pasqyrë e sfidave të mundshme të zhvillimit që mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta.

3. Shtojca II: Kushtet e përgjithshme, ku parashikohen përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit. Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni European nëpërmjet delegacionit të Bashkimit European në Tiranë.

4. Shtojca III dhe Shtojca IIIA: Modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë edhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë.

Një element që vlerësoj se duhet evidentuar është se ky program u hartua nëpërmjet një procesi konsultimi të gjerë, që përfshin aktorët vendorë dhe përfituesit potencialë në të dyja anët e kufirit, përfshirë edhe analizat *SWOT*, për të siguruar një nga treguesit për identifikimin e prioriteteve të përbashkëta për zonën ndërkufitare. Aktualisht, në këtë fazë është e vështirë të jepet një vlerësim real i të ardhurave dhe shpenzimeve pasi ndarja e buxhetit 1 380 000 për secilin shtet përfitues për alokimin e vitit 2016 mund të bëhet vetëm pas kontraktimit të projekteve fituese. Përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore, por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse, të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore.

Në aspektin e teknikës legjislative marrëveshja plotëson kërkesat formale të një marrëveshjeje. Për zbatimin e saj do të jetë përgjegjëse Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e koordinatores kombëtare të asistencës së Bashkimit European për Shqipërinë.

Në përfundim, duke vlerësuar se ky program bashkëpunimi midis dy vendeve do të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si dhe do të forcojë më tej bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve tona, i propozoj komisionit dhe të gjithë kolegëve miratimin e projektligjit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Bushati!

Ka pyetje? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në procesin e votimit.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Barbullushi, faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu për të rifilluar nesër në orën 10:00 ku do të prezantohet dhe diskutohet projektligji që miraton buxhetin faktik të vitit 2017 dhe raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit për buxhetin faktik të vitit 2017. Mund të jetë një seancë e gjatë, kështu që në orën 10:00 të jemi të gjithë prezentë në komision me qëllim që të fillojmë menjëherë.

Faleminderit dhe ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA